

ADMINISTRATA DOGANORE SHQIPTARE

Newsletter | Dhjetor 2024

DREJTORI I DOGANAVE GENTI GAZHELI NË TAKIMIN E PARË RAJONAL TË BE DHE UNODC



Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Genti Gazheli mori pjesë në takimin e parë Rajonal të Komitetit Drejtues të Programit të Promovimit të Veprimit të Përbashkët të BE dhe UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin).

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi forcimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë përmes masave të efektshme të kontrollit kufitar në porte dhe aeroporte, ku autoritetet doganore kanë një rol të rëndësishëm krahas Policisë Kufitare, partnerëve ndërkombëtarë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese.

Dogana Shqiptare ka pasur rezultate konkrete falë partneritetit me UNODC, si Programi i Kontrollit të Kontejnerëve. Po ashtu, përmes Njesisë së Kontrollit të Ngarkesave Ajrore, është përmirësuar ndjeshëm mbikëqyrja në aeroporte, duke rritur kapacitete në luftën ndaj trafikut të paligjshëm përmes rrugëve ajrore.

NËNSHKRUHET NË BUKURESHT MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT MES SELEC DHE BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT

Në funksion të bashkërendimit të përpjekjeve për rritjen e bashkëpunimit më të ngushtë ndërkombëtar në zbatimin e ligjit, u nënshkrua në Rumani një Marrëveshje Bashkëpunimi mes SELEC dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në emër të BKH, marrëveshja u nënshkrua nga Drejtoresha, znj. Aida Veizaj (Hajnaj) dhe në emër të SELEC nga Drejtori i Përgjithshëm Dr. Oğuz Serkant Akin.



Ceremonia u zhvillua në selinë e SELEC në Bukuresht në prani të një delegacioni të nivelit të lartë shqiptar, ku morri pjesë dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Genti Gazheli. Marrëveshja synon rritjen e bashkëpunimit mes BKH dhe SELEC në kryerjen e hetimeve cilësore në fushën e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

NDRYSHIMET E TRANZITIT SIPAS RREGULLOREVE TË BE, EKSPERTËT E ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE VIZITË NË DOGANËN E NAPOLIT

Një delegacion ndërinstitucional shqiptar, i kryesuar nga Njësia e Zbatimit të Projektit Western Balkans pranë Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit dhe me pjesëmarrjen e një grupi ekspertësh të Administratës Doganore Shqiptare zhvilluan një vizitë treditore në Doganën e Napolit, Itali. Vizita studimore u krye në kuadër të projektit Western Balkans - Trade and Transport Facilitation, projekt i cili financohet nga Banka Botërore.

Gjatë kësaj vizite u shkëmbyen eksperiencat, ku zyrtarët u njohën me ndryshimet e reja që do të pësojnë procedurat e Tranzitit sipas rregulloreve të BE si dhe u shpjeguan procedurat të rëndësishme tranzitit që do jenë së shpejti pjesë edhe e procedurave të Administratës Doganore Shqiptare, si një nga kriteret kryesore për të aderuar pranë BE-së.



DOGANAT BLOKOJNË 257 SHISHE VERË DHE 27 SHISHE ME PIJE TË TJERA ALKOOLIKE PA PULLË FISKALE

Nga kontrolli i ushtruar në Portin e Durrësit, në një autobus që vinte nga Ankona, nga inspektorët e Doganës dhe të Antikontrabandës, në bashkëpunim me inspektorët e Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Durrës, u bllokua një sasi prej 257 shishe verë dhe 27 shishe me pije të tjera alkooolike pa pullë fiskale. Për sasi të mësipërme u procedua me përlllogaritjen e detyrimeve doganore dhe sanksioneve përkatëse, bazuar në Kodin Doganor.



DOGANA SHQIPTARE MERR VLERËSIMIN E DHOMËS SË TREGTISË DHE INDUSTRIË TIRANË PËR BASHKËPUNIMIN ME SIPËRMARRJEN PRIVATE

Dogana Shqiptare mori vlerësimin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë për bashkëpunimin permanent me sipërmarrjen private përgjatë vitit 2024. Kryetari i Dhomës, Z. Nikolin Jaka, gjatë ceremonisë së shpërndarjes së çmimeve "CCIT Awards 2024", ka veçuar Forumin Biznes-Dogana i cili u mbajt gjatë muajit tetor, si shembull të këtij bashkëpunimi. Në këtë ceremoni ishin të pranishëm përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore, trupa diplomatike, akademikë dhe profesionistë të fushave të ndryshme.



DOGANA DIGJITALE



Drejtorja e Përgjithshme e Doganave është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës **E-Albania**.

Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit.

Gjatë vitit 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar **7796 shërbime online**.

A E DINI SE?

Çdo individ i cili dëshiron të eksportojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë një vepër arti, apo objekt që përbën trashëgimi kulturore, duhet ta deklarojë pranë Autoriteteve Doganore, si dhe të paraqesë lejet përkatëse të shoqëruar me pasaportën e objektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, apo Ministri i Kulturës.

Trashëgimia kulturore përfshin pasurinë kulturore materiale dhe jomateriale, të luajshme dhe të paluajshme, si një tërësi vlerash kulturore mbartëse të kujtesës historike dhe identitetit kombëtar, si dhe me rëndësi shkencore ose kulturore.

Disa nga objektet e **pasurisë kulturore** (të luajshme) mund të jenë:

- pikturat, fotografitë, koleksione të ndryshme;
- libra, dorëshkrime, dokumente historike, pulla;
- objekte arkeologjike, statuja;
- sende të ndryshme me vlerë artizanale, etnografike, historike, etj..